



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:237470

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05591005

AC-I-23-0294

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

B A, Prishtinë, i përfaqësuar nga avokatja N H, nga Prishtina.

Kundër

E paditura

NSH KB' 'Kosova' Prishtinë (në likuidim), përfaqësuar nga, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" Nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Djellza Hoxha gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-3374, të datës 19 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 18 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-3374, i datës 19 prill 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me datë 30 prill 2014, paditësi përmes postës e dërgon një ankesë në DHPGJS kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN082-0497, të datës 28 mars 2014, me të cilën kërkesa e paditësit për njohjen e të drejtës së pronësisë për ngastrën .. refuzohet si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit me datë 17.10.2011, ndërsa afati për paraqitjen e kërkesës sipas njoftimit të publikuar ishte data 17.12.2007, rrjedhimisht kërkesa ishte e pa afatshme. Autoriteti i Likuidimit konstaton se paditësi kërkesën e tij pronësore e ka mbështetur në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Lipjan C.nr.202/95 të datës 13.09.1996, i cili është bërë i formës së prerë me datë 27.02.1997, në bazë të cilit është kthyer prona këtij paditësi dhe personave të tjerë pas anulimit të kontratës së shitblerjes. Tutje Autoriteti i Likuidimit konstaton se me datë 24 shkurt 2014, i është dërguar një kërkesë paditësit me të cilin kërkohet që ai të dorëzojë dëshmi për ta justifikuar dorëzimin me vonesë të kërkesës si dhe të jep sqarime dhe të dorëzojë dokumentacion mbështetës duke sqaruar pse nuk e ka regjistruar pronën në fjalë në regjistrin kadastral në bazë të Aktgjykimit të formës së prerë. Autoriteti i Likuidimit po ashtu konstaton se paditësi i është përgjigjur kërkesës së Autoritetit të Likuidimit dhe ai ka deklaruar se nuk ka mund të dorëzojë kërkesën në afatin e përcaktuar tek Autoriteti i Likuidimit, pasi që për shkaqe shëndetësore ka qenë jashtë vendit në SHBA, ku ka bashkangjitur një kopje të vizës e cila ishte e vlefshme për periudhën 07.09.2005 e deri 30.03.2006. Autoriteti i Likuidimit pohon se ky arsyetim nuk mund të konsiderohet i vlefshëm pasi që ka të bëjë me periudhën para se NSH-ja të hynte në likuidim, e afati për dorëzimin e kërkesave ka qenë 17.12.2007. Andaj pasi që paditësi ka dështuar të arsyetojë vonesën, kërkesa e tij është refuzuar si e pa vlefshme.

Në ankesë paditësi i kundërshton konstatimet e dhëna nga Autoriteti i Likuidimit duke pohuar se vendimi është i pa drejtë dhe në kundërshtim me çdo dispozitë ligjore të legjislacionit në fuqi. Në ankesë ai pohon se e ka Aktgjykimin e plotfuqishëm C.nr.202/95 të Gjykatës Komunale në Lipjan i cili është bërë i plotfuqishëm me 27.02.1997, në bazë të cilit ai ka të drejtën e pronësisë për ngastrën kadastrale Nr..... Tutje në ankesë pohon se gabimisht është vërtetuar gjendja faktike dhe rrjedhimisht gabimisht është zbatuar edhe e drejta materiale me vendimin e ankimuar. Në ankesë ai kërkon ti njihet e drejta e pronësisë për ngastrën kadastrale Nr... në pjesën e tij ideale, pas marrjes së ekspertizës nga

eksperti gjeodet ose nëse kjo ngastër i është bartë personave të tretë, ti jepet një kompensim në vend të kësaj ngastre, ngastra Nr...., siç precizohet me ekspertizë. Me këtë ankesë ai ka bashkëngjitur një kopje të përgjigjes drejtuar AKP-së – Autoritetit të Likuidimit të datës 13 mars 2014, kopjen e vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, kopjen e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan C.nr.202/95 të datës 13.09.1996, një kopje të përgjigjes së KK Lipjan, dhe çertifikatën pronësore.

Me datë 12 janar 2018, paditësi dhe disa persona të tjerë me mbiemrin A dhe persona tjerë me mbiemër tjetër I kanë dorëzuar një parashtresë të cilën e quajnë plotësim i ankesës. Me këtë parashtresë ata i referohen Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan, dhe disa rasteve tjera për pronat tjera që në bazë të parashtresës janë kthyer personave tokat pas anulimit të kontratave. Me këtë parashtresë ata dorëzojnë kopje të Aktgjykimeve që i referohen personave të tjerë.

Me datë 21 nëntor 2018, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në padi. Në mbrojtjen në padi AKP-ja i kundërshton pretendimet pronësore të paditësit duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe pohon se kjo padi nuk përmban elementet nga neni 27 pika 2.4 të Shtojcës së LDHP-së dhe nenit 253 të LPK-së. Tutje AKP-ja konsideron se vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj, pasi që paditësi jashtë afatit ligjor kishte paraqitur kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit. Me këtë parashtresë AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 25 janar 2019, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë si përgjigje ndaj mbrojtjes në padi të AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi pohon se diku në vitin 2004 ose 2005 i është drejtuar AKM-së gojarisht, nëpunësit të saj me emrin N, i cili e ka mbushur një formularë për kërkesën time, të cilën e kam nënshkruar dhe ai e ka marrë, mirëpo nuk kam fotokopje të këtij formulari. Këtë fakt pohon ai mund ta vërteton ky person nëse diku është gjallë. Tutje ai pohon se më vonë përsëri kam shkuar në AKP dhe një person tjetër i quajtur F më ka udhëzuar ta plotësojë formularin duke e dorëzuar si të parin gjë të cilën e kam fotokopjuar dhe e kam marrë me vete. Me këtë parashtresë ai pohon se për shkak të problemeve shëndetësore unë pata shkuar në SHBA për shërim, ndërsa nuk kam pasur njohuri rreth çështjes së dorëzimit të kërkesave në afatin e përcaktuar.

Me datë 31 janar 2013, AKP-ja e dorëzon kundërpërgjigjen në të cilën ajo i përsërit pretendimet e veta të cekura në mbrojtjen në ankesë.

Me datë 17 mars 2023, është dorëzuar në DHPGJS një parashtresë nga paditësit tjerë K I, N I, B A, F A, Sh A, H A, A A, R A, M A, H H dhe I H, që të gjithë nga fshati K KK Lipjan. Në këtë parashtresë ata i referohen Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Lipjan C.nr.202/95, dhe kërkojnë që të gjitha lëndët e tyre aktive të regjistruara në DHPGJS si C-IV-14, të bashkohen me një lëndë dhe të trajtohen bashkërisht. Në këtë parashtresë ata i përshkruajnë numrat përkatës të këtyre lëndëve.

Me datë 19 prill 2023, Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-3374 ankesën e paditësit e refuzon si të pa bazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Kolegji i Shkallës së I-rë ka arsyetuar se paditësi ka dorëzuar kërkesën e tij tek Autoriteti i Likuidimit me 17 tetor 2011 ndërsa afati i fundit për parashtrimin e kërkesave tek Autoriteti i Likuidimit ndaj NSH KB "Kosova" (në likuidim) ka qenë data 17 dhjetor 2007, andaj kërkesa është e qartë se ishte e pa afatshme. Tutje Kolegji i Shkallës së I-rë ka konstatuar se Autoriteti i Likuidimit i ka dhënë rastin paditësit të dorëzojë dëshmi për ta justifikuar vonesën kaq të madhe për parashtrimin e kërkesës tek Autoriteti i Likuidimit. Paditësi ka dështuar të sjellë prova të besueshme për ta justifikuar vonesën në parashtrimin e kërkesës. Tutje Kolegji i Shkallës së I-rë konstaton se paditësi e ka sjellë një kopje të vizës amerikane e vlefshme prej datës 07 shtator 2005 e deri 06 mars 2006, por kjo provë nuk mund të arsyetoj vonesën meqë bëhet fjalë për periudhën kur ndër marrja ende nuk kishte hyrë në procedurë të likuidimit, ndërsa afati për parashtrimin e kërkesave siç u tha ka qenë data 17 dhjetor 2007. Nga këto arsye me të drejtë Autoriteti i Likuidimit e kishte refuzuar si të pavlefshme kërkesën.

Me datë 18 maj 2023, paditësi përmes postës e dërgoi në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-3374 të datës 19 prill 2023, për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të aprovohet ankesa e paraqitur ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe të

anulohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit si i kundërligjshëm. Për më tepër në ankesë paditësi pohon se Aktgjykimi i ankimuar përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të vlerësohet sepse ekzistojnë kundërthënie në mes të arsyeve të dhëna në Shkallën e I-rë dhe përmbajtjes së dokumenteve dhe shkresave të lëndës. Paditësi konstaton se nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike që lidhet me rrethanat objektive e subjektive të paditësit. Nuk është kontestuese se shpallja publike është bërë me datë 09.10.2007 dhe në parim paditësi ka pasur afat të paraqesë kërkesën deri me 17 dhjetor 2007. Kontestuese në këtë çështje mbetet çështja se Autoriteti i Likuidimit a e ka zbatuar drejt diskrecionin vetanak për të pranuar kërkesën pas afatit për parashtrimin e kërkesave. Në rastin konkret paditësi konsideron se në periudhën nga data 13.10.2007 e deri me 17.10.2011 kur është paraqitur kërkesa ankuesi ka qenë në SHBA dhe kjo vërtetohet nga vizat në pasaportën e tij personale. Ai pohon se menjëherë pas kthimit të përkohshëm në Kosovë me datë 15.10.2011 ka kuptuar lidhur me shpalljen publike, dhe ka paraqitur kërkesën pranë Autoritetit të Likuidimit, pra brenda afatit 30 ditësh nga rënia në dijeni e ankuesit për këtë proces të përcaktuar sipas nenit 35.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Nisur nga kjo gjendje faktike nga dita kur ka kuptuar për shpalljen ai e ka paraqitur ankesën dhe konsideron se është në afatin ligjor. Andaj për këtë arsye i gabuar është vendimi i Autoritetit të Likuidimit dhe Aktgjykimi i Shkallës së I-rë ku kërkesën e trajtojnë si të pa afatshme. Tutje paditësi pohon se Kolegji i Apelit ka arsye të plota e të pa mohueshme për ta zbatuar drejt çështjen e diskrecionit vetanak në drejtim të pranimit të kërkesës si të vlefshme të paraqitur pas afatit të rregullt sipas nenit 35.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Bashkë me ankesë ai dorëzon kopjen e pasaportës, dhe kopjen e vizës.

Me datë 25 maj 2023, paditësi e dorëzoi edhe një parashtresë në DHPGJS dhe me këtë parashtresë ai dorëzon autorizimin e avokatit N H për ta përfaqësuar në këtë kontest gjyqësor.

Me datë 03 korrik 2023, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditëses. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditëses si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për

mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 17 tetor 2011 e ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit për njohjen e të drejtës së pronësisë lidhur me ngastrën Nr...., të cilën të drejtë ai e ka bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Lipjan C.nr.202/95 i datës 13.09.1996, i cili Aktgjykim sipas paditësit është i formës së prerë nga data 27 shkurt 1997.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave tek Autoriteti i Likuidimit ishte data 17 dhjetor 2007.

Andaj pasi që kërkesa ishte e pa afatshme, Autoriteti i Likuidimit kërkesën e paditësit për njohjen e të drejtës së pronësisë për ngastrën ...e refuzon si të pavlefshme. Autoriteti i Likuidimit ja kishte dhënë rastin paditësit të dorëzojë dëshmi për ta justifikuar vonesën kaq të madhe mbi tri vite, por i cili ka dështuar të sjellë dëshmi të tilla.

Paditësi ka sjellë disa dëshmi se ka qëndruar në periudhën e cekur në SHBA, siç pohon ai trajtim mjekësor. Por vonesa e tij është aq e madhe, saqë i tejkalon kornizat kohore të përcaktuar me nenin 35.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, që parashikon që në afatin tjetër prej 30 ditësh nga dita e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e kërkesës, paditësi ishte i obliguar të paraqesë kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit.

Sipas nenit 35.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, nëse është vonuar një kreditor i supozuar apo bartësi i interesit për të parashtruar kërkesën me kohë, Autoriteti i Likuidimit ka në diskrecion vetanak mundësinë që një kërkesë e pa afatshme ta trajtojë si kërkesë të afatshme, nëse kreditori i supozuar apo bartësi i interesit paraqet kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit, jo më vonë se 30 ditë pas afatit për parashtrimin e kërkesave.

Në këtë rast afati i fundit për parashtrimin e kërkesave ka qenë 17 dhjetor 2007, ndërsa sipas nenit 35.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, paditësi ka mund të parashtrrojë kërkesën në afatin tjetër prej 30 ditësh me kusht që ta arsyetojë vonesën pse brenda 30 ditëve në afatin e dhënë nuk e ka paraqitur kërkesën. Ky afate është procedural dhe ai duhet të respektohet, për të qenë një kërkesë e pranueshme, dhe për të pasur mundësi Autoriteti i Likuidimit ta shqyrtoj në merita kërkesën.

Paditësi kërkesën e ka paraqitur tek me 17 tetor 2011, që është një vonesë tejet e madhe dhe nuk hynë në përkufizimin e kornizës kohore të përcaktuar me nenin 35.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Prandaj duke u bazuar në këtë gjendje faktike, Kolegji i Apelit konstaton se me të drejtë Autoriteti i Likuidimit e kishte refuzuar kërkesën e paditësit si të pa afatshme, ndërsa Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, po ashtu me të drejtë e kishte refuzuar ankesën e paditësit dhe e kishte vërtetuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Pasi që kërkesa e paditësit që nga fillimi ishte e pa afatshme, me të drejtë Autoriteti i Likuidimit dhe Shkalla e I-rë nuk janë marrë me meritat e kërkesës për njohjen e të drejtës së pronësisë lidhur me ngastrën Nr..., e që kjo e drejtë vërehet se është mbështetur në Aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Lipjan C.nr.202/95 i datës 13 shtator 1996.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit për shkak se kërkesa është e pa afatshme tek Autoriteti i Likuidimit, nuk do të marrët me meritat e kërkesës, dhe nuk do të

jap ndonjë vlerësim ligjor lidhur me Aktgjykimin e cekur të Gjykatës Komunale në Lipjan.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij në shkallën e dytë pohon se nga dita kur ai është vënë në dijeni për shpalljen e publikuar, duhet sipas tij të fillon afati për paraqitjen e kërkesës tek Autoriteti i Likuidimit, dhe konsideron se kërkesa e tij është e afatshme. Ky pretendim nuk është i bazuar në ligj, andaj nuk është marrë në konsideratë nga Kolegji i Apelit.

Dispozita e neni 35.3 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, i mundëson Autoritetit të Likuidimit që kërkesën e pa afatshme ta konsideron si të afatshme, nëse ajo paraqitet brenda afatit prej 30 dite, nga dita kur ka skaduar afati për paraqitjen e kërkesave, dhe kushti tjetër është që paditësi e ka barrën e provës për ta justifikuar vonesën. Në këtë rast nuk ka ndodhë as njëra, dhe as tjetra.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksa gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro, me datë 02 qershor 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
